DALËSE-IZLAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 0201-1064/1
-III-
Data Datum Date 17.10.2012

# Republika e Kosovës

**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**

***Qeveria - Vlada - Government***

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

Prishtinë, 10.10.2012
Nr. 01/793

**Për:** Isni Kilaj, Kryetar i Komunës Malishevë
Ragip Begaj, Kryesues i Kuvendit Komunal Malishevë

**Lënda:** Përgjigje në shkresë

I nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, më datën 04.10.2012, nga Kryetari i Komunës së Malishevës, ka pranuar kërkesën me Nr. 01/793 vlerësimin e ligjshmërisë së vendimeve lidhur me ndarjen e pronës komunale për ndërtimin e xhamive në fshatin Panorc, Rud, Guriq dhe Drenoc.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal duke u bazuar në kompetencat dhe afatin ligjor të përcaktuar në nenin 82, 83.3, të Ligjit Nr. 03/L040 për Vetëqeverisje Lokale, Rregulloren Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive ( shtojca XII ), pas shqyrtimit të hollësishëm të kërkesës në fjalë, për secilën çështje të ngritur jep shpjegime ligjore si vijon:

- Dhënia në shfrytëzim e pronës e paluajtshme të komunës, është në kundërshtim me nenin 5 të Ligjit nr. 03/L-226 dhe Udhëzimit Administrativ Nr.2012/02 për Zbatimin e Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

- Bazuar në nenin 5 të Ligjit nr. 03/L-226 dhe Udhëzimit Administrativ Nr.2012/02 për Zbatimin e Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës ka të drejtë që pronën komunale ta jep në shfrytëzim në afatshkurtër deri në 10 ( dhjetë ) vite dhe afatgjatë deri 40 ( dyzet ) vite, ashtu siç është përcaktuar me dispozitat ligjore të lartshënuara.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal është e përkushtuar që të ofroi ndihmën e nevojshme autoriteteve lokale, për zbatimin e plotë të obligimeve që dalin nga legjislacioni i aplikueshëm në Republikën e Kosovës.

Me respekt,

për
**Slobodan Petroviç,**
**Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MAPL,**

**Kopje:** *Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL-së*
*Drejtorëve të Departamenteve të MAPL-së*
*Arkivit të MAPL-së*

ALEŠE-IZLAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA - VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. 0201-1064/1
-III-

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada - Government***
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

Priština, 10.10.2012
Br. 01/793

**Za:** Isni Kilaj, Gradonačelnik Opštine Mališevo
Ragip Begaj, Predsedavajući Skupštine Opštine Mališevo

**PREDMET.-Odgovor na zahtev**

Poštovani ,

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, je dana 04.10.2012, od Gradonačelnika Opštine Mališevo, je primilo zahtev Br. 01/793 procenjivanje zakonitosti odluka u vezi dodele opštinske imoine za izgradnju džamije u selu Panorc, Rud, Gurić i Drenovac.

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave na osnovu nadležnosti i zakonskog roka odredjenog u članu 83.3, Zakona br. 03/L040 za Lokalnu samoupravu, Uredbe br. 02/2011 o poljima Administrativne odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva ( dodatak XII ), posle detaljnog razmatranja navedenog zahteva,za svako pokrenuto pitanje daje zakonsko objašnjenje koje sledi:

- Davanje na korišćenje opštinske nepokretne imovine je u suprotnosti sa članom 5 Zakona br. 03/L-226 i Administrativnog Uputstva Br.2012/02 za spovodjenje Zakona za davanje na korišćenje i razmenu opštinske nepokretne imovine.

- Na osnovu člana 5 Zakona br. 03/L-226 i Administrativnog Uputstva Br.2012/02 za spovodjenje Zakona za davanje na korišćenje i razmenu opštinske nepokretne imovine, Skupština Opštine ima pravo da daje opštinsku imovinu na korišćenje na kratkoročno do 10 ( deset ) godina i dugoročno do 40 ( četrdeset ) godina,onako kako je predvidjeno po Zakonu i Administrativnom Uputstvu.

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave je opredeljeno da pruži potrebnu pomoć lokalnim autoritetima,za potpuno spovodjenje obavaza koje proizilaze oo primenjivog zakonodavstva u Republiku Kosovo.

S poštovanjem,

**Slobodan Petrović,**
**Zamenik Premijera i Ministar MALS,**

**Kopija:** *Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a*
*Direktorima uprava MALS-a*
*Arhivi MALS-a*

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
KUVENDI KOMUNËS NË MALISHEVË

PRANUAR NË: 01.10.2012
Nr.Rr.Br. 01/

Nr.01/____
Datë:01.10.2012

Nga: Kryetari i Komunës, Isni Kilaj ecc.dip.

Për : Ministrinë për Administrimin e Pushtetit Lokal.
-Sekretarit të përhershëm.
-Depertamentit Ligjorë të MAPL-së.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Data / Datum / Date: 04.10.2012

| Njësia organizative | Nr. i Lëndës | Shtojca | Vlera |
|---|---|---|---|
| -III- | 0204-1064 | 6 | |

Kopje : Arkivit të komunës.

Datë: 01.10.2012.

Lënda : Kërkesë për shqyrtimin e ligjshmerisë të vendimit nr.02/24, të datës,09.02.2012 të Kuvendit të Komunës së Malishevës.

Të nderuar zotërinjë,

Kuvendi i Komunës së Malishevës, në mbledhjen e mbajtur me datë, 31.01.2012, ka miratuar kërkesën e kryesisë së fshatit,Drenoc për ndarjen e një lokacionit për ndërtimin e xhamisë në këtë fshat;
Duke u mbështetur në Ligjin për vetëqeverisjen lokale të komunave në Republikën e Kosovës Ligji nr.03/L-040, neni 14, nuk është e specifikuar se komuna, ka të drejtëtë ndajë lokacion për qëllimin e lartëcekur.
Vendimi i Kuvendit është nxjerrë duke u mbështetur në rregullen e nenit 11,12 para.12.2 shkronja ( d ) neni 35 dhe 40, ndërsa ne konsiderojmë se nuk kan mbështetje ligjore.
Pasi që destinimi për të cilin është ndarë lokacioni, nënkupton se kemi të bejmë me një procedurë të bartjes së pronësisë së pronës publike në një subjekt tjetër,me rastin e marrjes së vendimit të lartëcekur, andaj sipas vlerësimit ton nuk janë respektuar procedurat e parapara me Ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës Ligji nr.03/L-226.

Andaj, konform rregullës së nenit 78 dhe 81, të LVL-së, ( Ligji nr.L-040 ) kërkojmë, nga departamenti ligjorë në kuadër të MAPL-së, shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimeve të kuvendit të komunës së Malishevës të vendosura në seancën e mbajtur me datë,31.01.2012, dhe brenda afatit ligjorë,të kryhen procedurat ligjore konform rregulles se nenit 77 të, LVL-së ( Ligji nr.03/L-040).

Ju faleminderit për mirëkuptimin tuaj!

Me respekt.

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
KUVENDI KOMUNAL NË MALISHEVË

Nr. 02/ 24
Datë; 09 .02. 2012

Mbështetur në nenet 11,12.2 pika d, neni 35, 40 të Ligji për Vetëqeverisjen lokale - Ligji nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 10, 19 të Statutit të Komunës së Malishevës, rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa nr. 02/13 të datës 19.01.2012,

**Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e mbajtur më datë, 31.01.2012 mori këtë :**

# VENDIM

## PËR NDARJEN E PRONËS KOMUNALE PËR NDËRTIMIN E XHAMISË NË FSHATIN DRENOC

I. **Miratohet**,kërkesa e Kryesisë së fshatit Drenoc nr. 01/1555 datë 01.12.2011, si dhe kërkesa e këshillit të Bashkësisë Islame në Malishevë nr. 01/119 datë 17.01.2012, për ndarjen e një sipërfaqe tokësore për ndërtimin e Xhamisë në fshatin Drenoc, në sipërfaqe prej 0.40.00 ha.

?
Afati . 10 - 40

II. Lokacioni sipas pikës 1 të këtij vendimi është përcaktuar pjesa e ngastrës kadastrale nr. P-72310009-03022-0 në vendin e quajtur Kodra e Lazit e evidentuar në fletë posedim nr.199 pronë publike në emër të KK. të Malishevës Z.K. Drenoc

III. Ekzekutimin e këtij vendimi do ta bëjë, Kryetari i Komunës , përmes Drejtorisë për Gjeodezi, kadastër dhe Shërbim pronësoro - juridik të KK. të Malishevës.

IV. Obligohet, drejtoria për Gjeodezi, kadastër dhe shërbim pronësoro - juridik që brenda afatit të paraparë ligjor ti kryej procedurat që kanë të bëjnë me caktimin e pikave përkufizuese të parcelës sipas pikës 1 të këtij vendimi.

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë nga dita e miratimin nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës

Vendimi u dërgohet:
Arkivit,
MAPL-së

Kryesuesi i Kuvendit:
Ragip Begaj

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS-MALISHEVË
THE MUNICIPAL ASSEMBLY-MALISHEVË SKUPŠINA OPŠTINE-MALIŠEVO

PRANUAR MË:
ACCEPTED ON: 17/01/2012
PRIMLJENO:

Nr.No.Br. 01/119.

REPUBLIKA E KOSOVËS
BASHKËSISA ISLAME E KOSOVËS
KËSHILLI I BASHKËSISË ISLAME
Nr.4/2012
Dt:17.01.2012
MALISHEVË

PËR: KUVENDIN KOMUNAL MALISEHVË –Drejtorisë Për Gjeodezi dhe Kadaster .

Lënda: Regjistrim i pauajtshmërisë

Në bazë të Konfirmimit nr.01/105 datë 12.01.2012 të lëshuar nga Kryetari i Kuvendit Komunal Malishevë Z.Isni Kilaj me të cilin Komuna jep pajtimin e vet për ndërtimin e Xhamisë në Drenoc Komuna e Malishevës pikërisht në pronën publike e cila evidentohet ne emrin e KK Malisehvë,pikërisht në vendin e quajtur KODRA E LAZIT sipërfaqja 0.66.74 ha sipas nr.të njësisë P-72310009-03022-0.

Prandaj kërkojmë nga organi i lartpërmendur qe ta bartë të drejtën e pronësisë për këtë pauajtshmëri prej Kuvendit Komunal Malishevë në emrin e Këshillit të Bashkësisë Islame Malishevë pra paluajtshmërinë në vendin e quajtur KODRA E LAZIT sipërfaqja 0.66.74 ha sipas nr.të njësisë P-72310009-03022-0.

Me respekt....

Kryetari
Xhevat ef.Kryeziu

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE / MINISTARSTVO JAVNIH SLUZBI / MINISTRY OF PUBLIC SERVICES
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# ÇERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## MBI TË DREJTAT E PRONËS SË PALUAJTSHME / O PRAVIMA NA NEPOKRETNU IMOVINU / FOR THE IMMOVABLE PROPERTY RIGHTS

06-3980/2011 Fp.nr.: 199

| | |
|---|---|
| **Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office** | Malishevë/Mališevo/Malishevë |
| **Prona e Paluajtshme / Nepokretnu Imovinu / Immovable Property:** | P-72310009-03022-0 |
| **Data dhe Koha e Lëshimit / Datum i Vreme Izdavanja / Date and Time of Submission:** | 11/23/2011 - 3:14:21PM |
| **Komuna / Opština / Municipality:** | Malishevë/Mališevo/Malishevë |
| **Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:** | LLASHKADRENOC/VLAŠKI DRENOVAC/LLASHKA DRENOC |

## A PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të Drejtat Prava Rights | Emri Ime Name | Nr. ID Lb. ID ID No. | Vendbanimi Prebivalište Residence | Rruga Ulica Street | Nr. Br. No. | Kati Sprat Floor | Pjesa e pronës Deo imovine Part of scale | Azhuruar Ažurirano Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedues Posednik Possessor | P.SH.KUVENDI KOMUNAL | KCID2300096 | MALISHEVË | | | | 1/1 | Nga/Od/From KCID |

## B NJËSIA E PRONËS SË PALUAJTSHME - JEDINICE NEPOKRETNE IMOVINE - IMMOVABLE PROPERTY UNIT

| Nr. i Njësisë Br. Jedinice Unit No. | Llojet e Pronës Vrsta Imovine Property Class | Zona U/R Zona U/R Zone U/R | Shfrytëzimi Aktual Aktuelna Upotreba Actual Use | Vendi i quajtur Zvano mesto Place Name | Rruga Ulica Street | Nr. Br. No. | Kati Sprat Floor | Dhomat Sobe Rooms | Katet Spratovi Floors | Sipërfaqja (m2) Površina m² Area | L.Ndërtimore D.Izgradnje C.License | Azhuruar Ažurirano Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P-72310009-03022-0 | Parcelë Parcela Parcel | Unknown Unknown Unknown | | KODRA E LAZIT | | | | | | 6674 | - | |

Republika e Kosoves
K.K. Malishevë
Z.kad. Drenoc

# Kopje Plani

P:1:1000




me:17/01/2012

KOVENDIT KOMUNAL MALISHEVË

-Zyrës të Kryetarit 01/12/2011.

**KERKES**

Nr. 01/1555

Lenda:Kerkojm nga K.K që të na bëhet e mundeshme pjesa e ngastres katastrale nr.3022 në siperfaqe 60.00 ari në vendin e qujtur kodra e Lazit në emer të K.K.Malishevë pasi që është shenuar si pron shoqrore dhe ne banoret e Llashkadrenocit kerkojm nga K.K që të na bahet e mundëshme lirimi I vendit për ndertimin e Xhamis në fsh.Drenoc në siperfaqen e larg permendur dhe e njejta të bartet në pronsin e B.I.Malishevë për ket jemi të pajtimit të gjitha lagjet e fshatit .

Kesaj kerkese I bashkangjiten nenshkrimet e antarve te kryesis së fshatit:

1.Nuhi.S.Morina –Kryeplak .

2.Faik H. krasniqi-nënkryetar –Laca.

3.Astrit H. Krasniqi-Laca .

4.Hashim Z .Krasniqi-Laca.

5.Milazim I.Morina-Tupan .

6.Demush B.Krasniqi-Latif.

7.Ibish Sh.Krasniqi-Granta.

8.Sherif H.Morina-Mzez.

9.Avni V.Morina-Mzez.

10.Alush O.Krasniqi-Kapllan .

11.Qerim B.Krasniqi-Kapllan.

Malishevë.me 29.11.2011

KK.Malishevë
Z.Kad.Drenoc

**KOPJE PLANI**

P 1:1500




Me:23/11/2011

PRANUAR ME:
ACCEPTED ON: 07-09-2012
PRIMLJENO:

**REPUBLIKA E KOSOVËS** 01/798

KUVENDI KOMUNËS NË MALISHEVË

Nr.01/____
Datë:07.09.2012

Panorc
Rud
Goriq
Drenoc

Nga: Kryetari i Komunës, Isni Kilaj ecc.dip.

Për : Ministrinë për Administrimin e Pushtetit Lokal.
-Sekretarit të përhershëm.
-Depertamentit Ligjorë të MAPL-së.

Kopje : Arkivit të komunës.

Datë: 07.09.2012.

Lënda : Kërkesë për shqyrtimin e ligjshmerisë të vendimeve të Kuvendit të Komunës së Malishevës.

Të nderuar zotërinjë,

Kuvendi i Komunës së Malishevës, në mbledhjen e mbajtur me datë,30.08.2012, ka miratuar kërkesën e kryesisë së fshatrave,Panorc dhe Rud dhe kërkesën e fshatit Gurishtë për ndarjen e dy lokacioneve për ndërtimin e xhamive në këto fshatra;

-Vendimi nr.02/190, i datës 06.09.2012, për ndarjen e pronës komunale për ndërtimin e xhamisë për fshatrat Panorc dhe Rud.

-Vendimi nr. 02/191, i datës 06.09.2012, për ndarjen e pronës komunale për ndërtimin e xhamisë në fshatin Goriq.

Duke u mbështetur në Ligjin për vetëqeverisjen lokale të komunave në Republikën e Kosovës Ligji nr.03/L-040, neni 14, nuk është e specifikuar se komuna, ka të drejtërë ndajë lokacion për qëllimin e lartëcekur.
Vendimet e Kuvendit janë nxjerrë duke u mbështetur në rregullen e nenit 11,12 para.12.2 shkronja ( d ) dhe nenit 17, ndërsa ne konsiderojmë se nuk kan mbështetje ligjore.

HYRËSE-ULAZNA-INCOMING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Data / Datum / Date: 11.09.2012

| Njësia organizative | Nr. i Lëndës | Shtojca | Vlera |
|---|---|---|---|
| -III- | 0004-370 | 2 | |

Vendimi është marrë pa u konsultuar këshilla kryetarit të komunës,por vetëm duke shfrytëzuar të drejtën e votës në kuvend nga të gjitha subjektet politike të cilat janë të përfaqësuara.

Pasi që destinimi për të cilin është ndarë lokacioni, nënkupton se kemi të bejmë me një procedurë të bartjes së pronësisë së pronës publike në një subjekt tjetër,me rastin e marrjes së vendimeve të lartëcekura, sipas nesh nuk janë respektuar procedurat e parapara me Ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës Ligji nr.03/L-226.

Andaj konform rregullës së nenit 78 dhe 81, të LVL-së, ( Ligji nr.L-040 ) kërkojmë, nga departamenti ligjorë në kuadër të MAPL-së,shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimeve të kuvendit të komunës së Malishevës të vendosura në seancën e mbajtur me datë,30.08.2012, dhe brenda afatit ligjorë,të kryhen procedurat ligjore konform rregulles se nenit 77 të, LVL-së ( Ligji nr.03/L-040).

Ju faleminderit për mirëkuptimin tuaj!

Me respekt,

PRANUAR NË:
ACCEPTED ON: 06-09-2012

**R E P U B L I K A E K O S O V Ë S**

KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Nr.No.Br. 02/199

Nr. 02/____
Date: 06.09.2012

Mbështetur në nenet 11, 12 paragrafi 12.2 ( shkronja d ) nenin 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale ( Ligji nr.03/L-040), Rekomandimi te Komitetit për politike dhe financa nr. 02/162 të datës, 27.06.2012, si dhe bazuar në Statutin e Komunës së Malishevës .

Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e mbajtur më datë, 30.08.2012 mori këtë :

V E N D I M

PER NDARJEN E PRONËS KOMUNALE PËR NDËRTIMIN E XHAMISË NË FSHATIN GORIQ

Neni 1

**Miratohet**, kërkesa e Bashkësisë Islame në Malishevë nr. 02/145 datë 31.05.2012,si dhe kërkesa e kryesisë së fshatit Guriq për ndarjen e një sipërfaqe tokësore për ndërtimin e Xhamisë në fshatin Guriq në sipërfaqe prej 0.10.00 ha.

Neni 2

Lokacioni sipas pikes 1 të këtij vendimi eshte përcaktuar pjesa e ngastrës kadastrale nr. P-72310015-00956-0 në vendin e quajtur Rrafshina - Fshati e evidentuar në fletë posedim nr.52 , pronë publike në emer të KK. të Malishevës Z.K. Guriq.

Neni 3

Ekzekutimin e këtij vendimi do ta bëje, Kryetari i Komunës, përmes Drejtorisë për Gjeodezi, kadastër dhe Shërbim pronësoro - juridik të KK. të Malishevës.

Neni 4

Obligohet, drejtoria për Gjeodezi, kadastër dhe shërbim pronësoro - juridik që brenda afatit të parapare ligjor ti kryej procedurat që kanë të bëjnë me caktimin e pikave përkufizuese të parcelës sipas pikës 1 të këtij vendimi.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryesuesi Kuvendit të Komunës së Malishevës.

**Vendimi u dërgohet:**
Organeve kompetente
Arkivit
MAPL-së

Kryesuesi i Kuvendit:
Ragip Begaj

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I KOMUNËS MALISHEVË
THE MUNICIPAL ASSEMBLY MALISHEVË / SKUPŠTINA OPŠTINE MALIŠEVO

PRANUAR ME:
ACCEPTED ON: 06.09.2012
PRIMLJENO:
NUMRI: 02/1190

**R E P U B L I K A   E   K O S O V Ë S**

KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Nr. 02/
Date: 06.09.2012

Mbështetur në nenet 11, 12 paragrafi 12.2 ( shkronja d ), nenin 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale ( Ligji nr.03/L-040), Rekomandimit të Komitetit për politikë dhe financa nr. 02/163 të datës, 27.06.2012, si dhe bazuar në Statutin e Komunës së Malishevës .

**Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e mbajtur më datë, 30.08.2012 mori këtë :**

V E N D I M
**PËR NDARJEN E PRONËS KOMUNALE PËR NDËRTIMIN E XHAMISË NË FSHATIN PANORC**

Neni 1

Miratohet, kërkesa e kryesisë së fshatit Panorc dhe Rud nr. 02/149 datë, 06.06.2012 si dhe kërkesa e Bashkësisë Islame në Malishevë për ndarjen e një sipërfaqe tokësore për ndërtimin e Xhamisë në fshatin Panorc , në sipërfaqe prej 0.20.00 ha.

Neni

Lokacioni sipas pikës 1 të këtij vendimi është përcaktuar pjesa e ngastrës kadastrale nr. P-72310064-00640-0 në vendin e quajtur Rud Boka e evidentuar në fletë posedim nr.115 , prone publike në emër të KK. të Malishevës Z.K. Panorc.

Neni 3

Ekzekutimin e këtij vendimi do ta bëjë, Kryetari i Komunës , përmes Drejtorisë për Gjeodezi, kadastër dhe Shërbim pronësoro - juridik të KK. të Malishevës.

Neni 4

Obligohet, drejtoria për Gjeodezi, kadastër dhe shërbim pronësoro - juridik që brenda afatit të parapare ligjor ti kryej procedurat qe kanë të bëjnë me caktimin e pikave përkufizuese të parcelës sipas pikës 1 të këtij vendimi.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryesuesi Kuvendit të Komunës së Malishevës.

Vendimi u dërgohet:
Organeve kompetente
Arkivit,
MAPL-së

Kryesuesi i Kuvendit
Ragip Begaj